



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 25 maj 2015
Nr. ref.: RK 798/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI157/14

Parashtrues

Hajriz Alidemaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 1579/2014,
të 8 shtatorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Hajriz Alidemaj me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë [C. nr. 1579/2014], i 8 shtatorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jetë shkëlur neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 tetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Artar Rama-Hajrizi dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 8 dhjetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 16 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Prej 1 shtatorit 1981 deri më 31 gusht 2003, parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar si mësues i gjuhës shqipe në shkollën “28 Nëntori” në Prishtinë. Pas 31 gushtit 2003, Komuna e Prishtinës ia ka ndërruar shkollën ku ka punuar parashtruesi i kërkesës, dhe me këtë edhe pagën bazë.
10. Parashtruesi i kërkesës disa herë i është drejtuar Ministrisë së Arsimit të Kosovës dhe Komunës së Prishtinës lidhur me këtë çështje, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.
11. Më 6 qershor 2006, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMK), kundër vendimeve të Komunës së Prishtinës për transferimet e lartpërmendura dhe ndryshimet e pagës bazë.

12. Më 21 mars 2007, KPMK-ja [Vendimi A 02 114/2006] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e vendimit të tij, KPMK-ja theksoi:

„Këshilli duke u bazuar në provat shkresore të prezantuara ka konkluduar se kërkesa e ankuesit lidhur me koeficientin e pagës është e bazuar dhe duhet aprovuar, ndërsa kërkesa për tu kthyer në vendin e mëparshëm të punës, varet nga nevojat e organit të punësimit në bazë të organizimit të punës dhe sistemit të punësuarve”.

13. Më 24 janar 2011, parashtruesi i kërkesës kërkoi përmbarim nga Gjykata Themelore në Prishtinë, duke kërkuar që të kthehet në vendin e mëparshëm të punës.

14. Më 17 nëntor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë [Aktgjykimi C. nr. 122/2011] aprovoi padinë e parashtruesit dhe urdhëroi Komunën e Prishtinës - Drejtorinë për Arsim dhe Shkencë, që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin dhe detyrat e punës në të cilat ai ka punuar si mësimdhënës i gjuhës shqipe në shkollën “28 Nëntori” në Prishtinë, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, dhe të paguajë diferencën e të ardhurave personale për periudhën prej 1 shtatorit 2003 deri më 30 shtator 2011.

15. Komuna e Prishtinës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

16. Më 13 maj 2014, Gjykata e Apelit [Aktvendimi Ac. nr. 3142/2012] anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe ktheu rastin në Gjykatën Themelore për rigjykim.

17. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata e Apelit theksoi:

„Gjykata e shkallës së parë në ri procedurë do të eliminoj të cekurat si më lartë, ashtu që do të vërtetoj sipas detyrës zyrtare afatshmërinë e kërkesëpadisë, duke pasur parasysh faktin se vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës është i datës 21.03.2007, ndërsa padia kësaj gjykate është dorëzuar me datë 24.01.2011 dhe pas vlerësimit do të merr një vendim të drejtë e të ligjshëm”.

18. Më 8 shtator 2014, Gjykata Komunale [Aktvendimi C. nr. 1579/2014] refuzoi ankesën e parashtruesit si të paafatshme, me arsyetimin:

„Me provat e administruara gjykata gjeti se paditësi padinë e ka parashtruar me datë 24.01.2011. Me datë 21.03.2007 e ka pranuar aktvendimin me të cilin i ndërprehet marrëdhënia e punës. Afati i parashkrimit për të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës, ndërsa paditësi është pensionuar me datë 21.03.2007 kurse padinë e ka bërë me datën 24.01.2011 pas tre vite e nëntë muajve“.

19. Më 10 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës kundër Aktvendimit [C. nr. 1579/2014] të Gjykatës Komunale. Procedura në Gjykatën e Apelit është ende në zhvillim e sipër.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Komuna e Prishtinës ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Kosovës.
21. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

„kërkoj vazhdimin e pagesës në mënyrë retroaktive nga paga prof. i shkollës m. në pagën mësues në shk. fillore (...) dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës prof. i gjuhës shqipe“.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (7) të Kushtetutës, i cili parasheh:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata i referohet edhe nenit 47. 2 të Ligjit, i cili parasheh:

„Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj“.

25. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

„Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar“.

26. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës deklaroi se Komuna e Prishtinës ka shkelur të drejtën e tij të punës dhe ushtrimit të profesionit, të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës së Kosovës.
27. Gjykata vëren se më 10 dhjetor 2014, parashtruesi i kërkesës inicioi padi në Gjykatën e Apelit ku procedura është ende në zhvillim e sipër.
28. Gjykata më tej rikujton se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës të shterojë të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
29. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i

karakterit subsidiar të Kushtetutës (Shih: Aktvendim për papranueshmëri: *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, i 27 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

30. Prandaj, Gjykata konsideron që kërkesa e parashtruesit është e parakohshme, për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës.
31. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 maj 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani